



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

Nr. 1235 prot.

Tiranë, më 08 .04.2019

URDHËR

Nr. 80 , datë 08 .04.2019

“PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË PROCEDURALE DHE MATERIALE TË
KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË SË AVOKATËVE TË SHTETIT NGA ZYRA E
INSPEKTIMIT”

Në mbështetje të shkronjës “a” dhe “k”, të nenit 6 të të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, të pikës 6 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Metodologjisë së elementeve proceduralë dhe materialë të kontrollit të veprimitarisë së avokatëve të shtetit nga Zyra e Inspektimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohet Zyra e Protokollit pranë Avokaturës së Shtetit për njoftimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

Artur Metani



METODOLOGJIA E ELEMENTËVE PROCEDURIALË DHE
MATERIALË TË KONTROLLIT TË VEPRIMTARISË SË AVOKATËVE
TË SHETIT NGA ZYRA E INSPEKTIMIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Kjo metodologji, bazohet në Ligjin nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar, VKM-në nr.392, dt. 08.09.2009 “Për miratimin e Rregullores për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, roli i avokatëve të shtetit në gjykim si dhe normat e posaçme procedurale”, në pikën 6 të nenit 19 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 29.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Kjo metodologji është e detyrueshme për t’u zbatuar gjatë procesit të verifikimit, inspektimit nga ana e avokatëve të shtetit pjesë e Zyrës së Inspektimit dhe nga të gjithë avokatët e shtetit, të cilët mbi bazë të urdhërit të Avokatit të Përgjithshëm për kryerjen e inspektimit/verifikimit, janë objekt i saj.

KREU II
ZYRA E INSPEKTIMIT

Neni 3
Objekti i veprimtarisë së Zyrës së Inspektimit

Objekti i veprimtarisë së Zyrës së Inspektimit është:

- a. Vlerësimi i ankesave dhe verifikimet përkatëse;

- b. Inspektimi i avokatëve të shtetit të zyrës qëndrore, zyrove vendore dhe avokatëve të shtetit pranë ministrive;
- c. Mbledhja e të dhënave rreth veprimtarisë së avokatëve të shtetit nëpërmjet realizimit të detyrave të përcaktuara në pikat a dhe b të këtij neni;
- d. Paraqitja përpara Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit të rezultateve të verifikimit dhe inspektimeve të kryera në rastet kur pretendohet se është konstatuar ekzistenca e shkeljeve disiplinore, mbi të cilat inicohet procedimi disiplinor i avokatëve të shtetit;
- e. Klasifikimi i shkeljes së konstatuar;
- f. Propozimi i inspektimeve tematikë apo proceduralë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit;
- g. Dhe çdo detyrë tjetër e ngarkuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Neni 4

Organizimi dhe drejtimi

1. Zyra e Inspektimit është e organizuar si strukturë në nivel qëndror në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit dhe ka varësi të drejtpërdrejtë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.
2. Veprimtaria e Zyrës së Inspektimit organizohet dhe drejtohet nga drejtuesi i Zyrës së Inspektimit, i emëruar si i tillë me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
3. Drejtuesi i Zyrës së Inspektimit organizon dhe përgjigjet për veprimtarinë e përditshme të Inspektimit lidhur me planifikimin dhe ndarjen optimale të punës si dhe marrjen e masave për vënien në dispozicion të mjeteve logjistike të nevojshme për përmbushjen e detyrave.
4. Zyra Inspektimit, kryen inspektimin e avokatëve të shtetit në të dyja nivelet, në bazë të planit të përgjithshëm apo analitik të inspektimit dhe/ose ankesave të shtetasve apo subjekteve të tjera, si dhe ato të publikuara në media vizive apo te shkruar.

Neni 5

Detyrat e Zyrës së Inspektimit

1. Drejtuesi dhe avokatët e shtetit në Zyrën e Inspektimit, përgjigjen përpara Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit në përmbushje të veprimtarisë së përditshme të tyre. Urdhërat dhe udhëzimet e këtij të fundit janë të detyrueshme për zbatim.
2. Zyra e Inspektimit, bën verifikimin e ankesave të shtetasve dhe të subjekteve të tjera që, i drejtohen Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit apo ato të publikuara në media, me qëllim

evidentimin e situatave faktike në veprimtarinë e avokatëve të shtetit, duke dhënë rekomandime për zgjidhjen e problematikave të konstatuara apo duke përgatitur relacionet përkatëse për veprime të avokatëve në të dyja nivelet, të vlerësuara në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

3. Zyra e Inspektimit fillon procedurat përkatëse në zbatim të kësaj metodologjie edhe për ankesa/rekomandime të drejtuara me shkrim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar, me kushtin që ankesa/rekomandimi të plotësojë këto kushte:

a) të jetë me shkrim;

b) të identifikojë avokatin e shtetit, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

4. Zyra e Inspektimit nuk vihet në lëvizje në rastet e ankesave/rekomandimeve anonime drejtuar Avokatit të Përgjithshëm apo Avokaturës së Shtetit

5. Zyra e Inspektimit vihet në lëvizje dhe bën pjesë të programit të saj të inspektimit ankesën/rekomandimin, i cili është vlerësuar paraprakisht për verifikim nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe i është përcjellë me shënimin përkatës Zyrës së Inspektimit, për të realizuar verifikimet përkatëse në lidhje me rastin konkret.

6. Detyra të tjera të Zyrës së inspektimit janë:

a) Verifikon në çdo rast shqetësimet apo informacionet e përcjellura nga drejtuesit e zyrave të Avokaturës në të dyja nivelet;

b) Kryen, bazuar në udhëzimet e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, inspektime të përgjithshme, inspektime tematike ose për çështje të veçanta në të dy nivelet e organizimit të institucionit;

c) Kryen inspektimin e performancës së avokatëve gjatë dhënies së asistencës juridike qoftë kjo gjatë ushtrimit të funksionit të përfaqësimit, qoftë gjatë ushtrimit të funksionit të këshillimit;

d) Verifikon frekuentimin dhe pjesëmarrjen e avokatëve të shtetit në procese gjyqësore;

- e) Verifikon aspektin formal dhe cilësinë e dokumentacionit të mbrojtjes, të hartuara nga avokatët e shtetit si dhe përmbajtjen e tyre, kur i kërkohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
- f) Verifikon administrimin e fashikujve gjyqësorë, mbajtjen e kartelave shoqëruese bashkëlidhur fashikullit gjyqësor dhe inventarin e dosjes përkatëse të avokatit të shtetit ndaj të cilit po zhvillohet inspektimi;
- g) Verifikon respektimin e afateve të dorëzimit të mbrojtjeve dhe të çdo akti tjetër, që është hartuar nga avokati i shtetit ndaj të cilit po zhvillohet inspektimi;
- h) Konstaton nëse ka, dëmin e shkaktuar të interesave pasurore të shtetit si dhe dëmin e parandaluar për shtetin në dokumentacionin e hartuar apo administruar nga avokati i shtetit, ndaj të cilit po zhvillohet inspektimi;
- i) Heton dhe verifikon në rrugë administrative, në zbatim të Kodit të Procedurës Administrative dhe Metodologjisë së Inspektimit të miratuar nga Avokati i Shtetit, nëse avokatët e shtetit ushtrojnë aktivitete publike ose private gjatë ose jashtë orarit zyrtar të punës, që përbëjnë konflikt interesi me detyrën e tyre;
- j) I propozon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit kryerjen e inspektimit, duke i drejtuar kërkesë këtij të fundit, për miratim, në raste se konstatojnë shkelje të punës së Avokatit të Shtetit;
- k) Ka akses dhe verifikon hedhjen dhe përditësimin e të dhënave në regjistrin elektronik të proceseve gjyqësore nga avokatët e shtetit brenda ditës, në të cilën janë realizuar veprimet (depozitimet e akteve në gjykatë, ecuria e seancës konkrete gjyqësore etj);
- l) Pas kryerjes së inspektimit dhe daljes së rezultateve të tij, i propozon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit fillimin e procedimit disiplinor për avokatët e shtetit sipas ligjit duke klasifikuar llojin e masën disiplinore;
- m) Harton raporte me shkrim drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit lidhur me rezultatet e inspektimit të performancës së avokatëve të shtetit, mbi bazë të kërkesave dhe afateve të urdhërit të inspektimit;
- n) I propozon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit përmirësimin e praktikës administrative me qëllim rritjen e efektivitetit në zbatim të detyrave, që ligji i ngarkon institucionit;

- o) Verifikon në praktik realizimin nga ana e avokatëve të shtetit për çështjet e deleguara, apo të relatuara nga Avokatët e Shtetit, nëse këto delegime apo relatime janë bërë në përputhje me ligjin dhe aktet normative të brendshme të avokaturës;
- p) Verifikon aposteriori cilësinë e këshillimeve ligjore të kryera nga avokatët e shtetit dhe ia relatton qëndrimin e saj Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Kontrollon aposteriori cilësinë e akteve të Zyrës së Këshillit dhe Koordinimit Ndërministror si dhe të GJEDNJ-së, arbitrazhit, gjykatat ndërkombëtare, verifikon ecurinë e nismave ligjore që ndërmerren kryesisht me iniciativën e Avokatëve të shtetit në nivel vendor dhe qendror;
- q) Verifikon zbatimin e legjislacionit në fuqi për Avokaturën e Shtetit dhe çdo akt tjetër nënligjor që drejton veprimtarinë e punës së avokatëve të shtetit;

Neni 6

Propozimi i masave disiplinore

1. Pas kryerjes së inspektimit dhe daljes së rezultateve të tij, në rast se është konstatuar ekzistenca e shkeljes disiplinore, grupi i inspektimit të Zyrës së Inspektimit, në raportin që do t'i përcillet Avokatit të Përgjithshëm, i propozohet edhe masa disiplinore konkrete, që i adresohet shkeljes konkrete të konstatuar.
2. Propozimi i masës disiplinore do të jetë një prej masave të mëposhtme:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje me paralajmërim;
 - c) shkarkim nga detyra.
3. Në raportin e shkeljes që do t'i përcillet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, duhet të përcaktohet qartë dhe me argumenta konkret të faktuar llojet e shkeljeve si më poshtë vijon:
 - a) të lehta të tilla si:**
 - veprimet dhe mosveprimet e avokatit të shtetit, të cilat pasjellin zvarritje të proceseve gjyqësore;
 - mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë;
 - akte dhe sjellje të tjera, që diskretitojnë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.
 - b) të rënda të tilla si:**

- zvarritja e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve të avokatit të shtetit, gjatë ushtrimit të funksioneve të parashikuara me ligj, kur ajo ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për interesat pasurorë të shtetit;
- braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë, në rastet kur ky veprim ka sjellë ose mund të sillte pasoja të rënda për interesat pasurorë të shtetit;
- bërja publike e akteve ose e dokumenteve zyrtare, e të dhënave apo regjistrimeve me karakter sekret ose konfidencial;
- pengimi i inspektimeve të kryera sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- thyerja e disiplinës në punë, në mënyrë të përsëritur dhe pas paralajmërimit të dhënë me shkrim nga eprori;
- humbja e çështjes gjyqësore, si rezultat i nivelit të dobët të përfaqësimit në proces.

c) shumë të rënda të tilla si:

- rastet, kur provohet se avokati i shtetit ka përdorur funksionin e tij në shërbim të interesave vetjakë apo të personave, me të cilët ka lidhje familjare;
- rastet kur provohet se avokati i shtetit, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka krijuar favore për persona të tjerë, në dëm të interesave të shtetit;
- rastet kur avokati i shtetit shkel dispozitat e këtij ligji dhe të kodit të etikës, të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
- rastet kur avokati i shtetit ka këshilluar në kundërshtim me interesat e institucionit qendror, që ka kërkuar konsulencën;
- rastet kur provohet se ka shkelur urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;
- rastet kur avokati i shtetit kryen vepra penale, që lidhen me ushtrimin e detyrës;
- akte dhe sjellje të tjera, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit.

Neni 7

Organizimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektimit

1. Organizimi i veprimtarisë së punës së Zyrës së Inspektimit bazohet në misionin, objektivat e institucionit të Avokaturës së Shtetit, në planin e punës vjetor të miratuar nga

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, apo detyrave të ngarkuara në çdo kohë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

2. Zyra e Inspektimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, mban në konsideratë dhe respekton parimet e:
 - a. Ligjshmërisë;
 - b. Garantimit të një procesi të rregullt disiplinor;
 - c. Formalizimit të procedurave;
 - d. Ndalimit të ribërjes së një procedure të trajtuar më parë;
 - f. Klasifikimit të shkeljes;
 - g. Mosdiskriminimit.
3. Nëpërmjet inspektimit, grumbullohen të dhëna në analizë të të cilave, evidentohet efektiviteti i shërbimit të ofruar në konsideratë të standardeve të përcaktuara të shërbimit në drejtim të strukturës organizative dhe infrastrukture, të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe këshillimit, me qëllim bërjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen apo marrjen e masave efektive për eliminimin e anomalive të ndeshura.
4. Inspektimi i avokatit të shtetit mund të ketë karakter njohës të efektivitetit të veprimtarisë ose për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore të tij.
5. Inspektimi i avokatit të shtetit në të dy nivelet, mund të jetë me karakter të përgjithshëm ose tematik.

Neni 8

Verifikimi i ankesave/rekomandimeve ndaj veprimtarisë së avokatëve të shtetit

1. Verifikimi i ankesës/rekomandimit, është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve apo shqetësimeve për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e avokatit të shtetit subjekt i inspektimit dhe që realizohet nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës dhe ballafaqimit të të dhënave konkrete.
2. Ankesa mund të shërbejë për kryerjen e një inspektimi të përgjithshëm dhe/ose tematik të veprimtarisë së avokatit të shtetit.
3. Në çdo rast, Zyra Inspektimit nuk mund të mos trajtojë pa shkak një ankesë të marrë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Neni 9

Objekti i verifikimit të ankesës

1. Objekt verifikimi të ankesave mund të jenë:

- a. Faktet apo rrethanat që kanë të bëjë me mosfunksionimin normal të punës së zyrës së avokaturës në nivel qëndror/vendor.
- b. Faktet apo rrethanat që mund të konsiderohen shkelje në referim të detyrave të avokatit të shtetit, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektimin formal të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- c. Mos planifikimi dhe mos organizimi i punës, që kanë ndikuar apo tregojnë dukshëm për zvarritje të pajustificuar të punës, e cila ka sjellë pasoja.

2. Nuk përbëjnë objekt verifikimi të ankesave :

- a. Pretendimet për fakte apo rrethana që mund të zgjidhen nëpërmjet inspektimit mbi apelimin gjyqësor të palëve, ç'ka nënkupton se nuk përfshihen në objektin e verifikimit ato fakte apo rrethana të parashtruara që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit në një rast konkret nga ana e avokatit të shtetit.
- b. Sjellja në jetën private të avokatit të shtetit, përveçse kur ajo ka shkaktuar një jehonë të gjërë në publik, që lidhet me detyrën e tij dhe vlerësohet se është diskretituese për figurën e avokatit.

Neni 10

Depozitimi i ankesës

1. Verifikimi mund të fillojë mbi bazën e një ankesë të depozituar pranë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ose mbi bazën e çdo ankesë apo shqetësimi tjetër të bërë publik nëpërmjet medias.
2. Ankesat mund të depozitohen nëpërmjet shërbimit postar ose drejtpërdrejt në Zyrën e Protokollit.
3. Ankesat e depozituara në Zyrën e Protokollit i kalojnë menjëherë Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i cili autorizon për trajtim drejtuesin e Zyrës së Inspektimit.
4. Ankesat e depozituara si dhe ato të bëra publike nëpërmjet mediave, regjistrohen në Regjistrin e Ankesave, që duhet të përmbajë këto rubrika :

- a. Identiteti i ankuesit;
 - b. Avokatin e shtetit ndaj te cilit adresohet ankesa;
 - c. Përmbajtja e ankesës;
 - ç. Llojin e shkeljes së pretenduar.
 - d. Data e nxjerrjes së urdhërit të verifikimit.
 - e. Avokati i shtetit i ngarkuar për verifikim.
 - f. Data e marrjes së ankesës dhe urdhërit të verifikimit nga avokati i shtetit.
 - g. Data e depozitimit të praktikës së verifikimit nga Avokati i Shtetit.
 - h. Mënyra e përfundimit të trajtimit apo verifikimit.
5. Regjistri i ankesave mbahet nga një prej avokatëve të shtetit pranë Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, të përcaktuar më Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm.

KREU III

ADMINISTRIMI I ANKESËS/REKOMANDIMIT

Neni 11

Vlerësimi paraprak i ankesës

1. Në çdo rast, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mbas dorëzimit të raportit nga Zyra e Inspektimit mbi ankesën, vendos nëse ka vend për verifikim.
2. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit urdhëron arkivimin apo kryerjen e verifikimit të ankesës, mbas relatimit nga Zyra e Inspektimit.
3. Kur ankesa vlerësohet e papërshtatshme në formë dhe në përmbajtje dhe urdhërohet arkivimi i saj, ankuesit i kthehet menjëherë përgjigje nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit ku parashtrohen shkaqet dhe arsyet e moskryerjes së verifikimit.
4. Ankesa e ripërsëritur arkivohet pa u verifikuar, përjashtuar rastin kur në ankesën e radhës parashtrohen fakte e rrethana të reja të vlefshme për verifikim.
5. Në rastin kur vlerësohet se ka vend për verifikim të ankesës, Avokati i Përgjithshëm me Urdhër, ngarkon Zyrën e Inspektimit për kryerjen e tij.

Neni 12

Urdhëri i Verifikimit

1. Për kryerjen e verifikimit të ankesën Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr një Urdhër të posaçëm të shkruar për verifikimin, ku përcakton :

- a. Emrat e avokatëve të shtetit pranë Zyrës së Inspektimit që do të kryejnë verifikimin;
- b. Lëndën objekt verifikimi;
- c. Detyrat e verifikimit;
- d. Afatin e kryerjes së verifikimit.

Neni 13

Urdhëri i Inspektimit

1. Për kryerjen e inspektimit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit nxjerr një Urdhër të shkruar, ku përcakton:

- a) Emrat e avokatëve të shtetit pranë Zyrës së Inspektimit, që do të kryejnë inspektimin;
- b) Avokatin e shtetit ndaj të cilit do të realizohet inspektimi;
- c) Lëndën objekt inspektimi;
- d) Detyrat e inspektimit;
- e) Afatin e kryerjes së inspektimit.

2. Kryerja e inspektimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e Urdhërit për inspektim. Për shkaqe të përligjura, përveçse kur është parashikuar ndryshe në ndonjë akt tjetër, afati i inspektimit mund të shtyhet për 30 ditë, por gjithmonë me miratimin paraprak me shkrim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

3. Në inspektimin e avokatit të shtetit në të dyja nivelet mund të merren në konsideratë dhe të dhënat që përfshihen në dosjen e personelit dhe inspektimet e mëparshme në vite.

4. Inicimi i një inspektimi të përgjithshëm apo tematik vendoset nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit:

- a. Mbi bazën e një kalendari paraprak pune;
- b. Mbi një rast apo një situatë problematike të vlerësuar serioze, për të cilën Avokati i Përgjithshëm i Shtetit është vënë në dijeni ose ka marrë indicie nga subjekte të tretë;

5. Inspektimi mund të shtrihet përgjatë një periudhe 1 vjeçare, duke përfshirë dhe kontrollin e çështjeve në gjykim e sipër, por në këtë rast vetëm në aspektin e respektimit të afateve dhe ngarkesës së punës.

Neni 14

Zëvendësimi i avokatëve të shtetit

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për arsye të përligjura, mund të urdhërojë zëvendësimin e një apo disa avokatëve të shtetit nga një procedurë verifikimi/inspektimi edhe pas fillimit të procedurave.
2. Veprimet e kryera nga avokati apo avokatët e zëvendësuar janë të vlefshme përderisa arsyeja e përligjur nuk lidhet drejtpërdrejt me to.

Neni 15

Kryerja e verifikimit

1. Avokatët e shtetit të Zyrës së Inspektimit në çdo rast, pavarësisht nga detyrat e lëna në Urdhër verifikon vërtetësinë e pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, si dhe kryesisht çdo çështje që lidhet me funksionimin apo veprimtarinë normale të avokatit të shtetit në nivel qëndror/vendor, që është e dukshme dhe që mund të konsiderohet nga ligji si shkelje disipline.
2. Në çdo rast verifikimi, Zyra e Inspektimit vë në dijeni drejtuesin e Zyrës së Avokaturës dhe avokatin e shtetit përkatës, duke i njohur ata me ankesën dhe Urdhërin e verifikimit.
3. Në rastin kur konstatohet se ankesa lidhet me një proces gjyqësor që është në gjykim e sipër, verifikimi kryhet vetëm për pretendime që lidhen me zvarritje të procesit gjyqësor apo për çështje të etikës.

Neni 16

Raporti i inspektimit të avokatit të shtetit

1. Në përfundim të inspektimit, Zyra e Inspektimit përgatit Raportin përkatës që domosdoshmërisht duhet të përmbajë :
 - a) Grupin e Avokatëve të shtetit që kanë kryer inspektimin;
 - b) Avokatin e shtetit ndaj të cilit është bërë inspektimi;
 - c) Objektin e inspektimit;
 - d) Pretendimet e ngritura nga subjekti i inspektuar;

- e) Parashtrimin e të dhënave të rastit të inspektuar;
- f) Konkluzionet e inspektimit;
- g) Propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të inspektimit;
- h) Të dhëna statistikore për cilësinë dhe ngarkesën e punës së avokatit të shtetit;
- i) Të dhëna për respektimin nga ai të afateve sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Civile dhe akteve të tjera ligjore;
- j) Të dhëna për planifikimin dhe organizimin e punës;
- k) Çdo të dhënë tjetër, që vlerësohet domethënëse për efektivitetin dhe aftësitë e tij profesionale.
- l) Konkluzione rreth efektivitetit të shërbimit të ofruar nga avokati i shtetit.
- m) Kur është rasti, vërejtje dhe rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë;
- n) Kur është rasti, përshkrimi i veprimtarive të avokatit të shtetit, ku konstatohen shkelje të ligjit që konsiderohen si shkelje disipline.

2. Raporti i inspektimit ndaj avokatit të shtetit në të dyja nivelet i bëhet me dije Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, së bashku me konkluzionin përkatës. Në përfundim të çdo inspektimi, raporti përfundimtar do konsistoj në :

- shkeljet e evidentuara në mënyrë të hollësishme, ç'ka do të thotë dërgimin e raportit për Komisionin e Disiplinës, i cili do vazhdoj më tej vlerësimin e praktikës.
- lënien e rekomandimeve që mund të ketë për avokatin e shtetit, por që nuk ka shkelje ligjore, ç'ka passjell pas komunikimit të raportit të inspektimit avokatit të shtetit dhe pritjes së observacioneve që mund të ketë, të kaloj për arkivim pas miratimit nga APSH.

3. Raporti i inspektimit, bëhet pjesë përbërëse e dosjes së tij personale.

4. Gjithashtu, në përmbushje të detyrave Grupi i Inspektimit, veprimet e kryera i dokumenton në procesverbale të ndryshme, të cilat duhet të përmbajnë :

- a. Avokatin e shtetit të ngarkuar për verifikim/inspektim;
- b. Datën e kryerjes së verifikimit/inspektimit;
- c. Objektin e verifikimit/inspektimit;
- d. Personat pjesëmarrës në procedurat e verifikimit/ inspektimit;
- e. Përmbajtjen e hollësishme të veprimit/veprimeve të kryer.

f. Nënshkrimin në fund të çdo faqeje të avokatit të shtetit dhe të personave pjesëmarrës në veprimin verifikues.

Neni 17

Mënyra e përfundimit të inspektimit të avokatit të shtetit për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore.

Nëse nga inspektimi i veprimtarisë së avokatit të shtetit rezultojnë dhe raste apo veprime gjyqësore të tjera, ku konstatohet që janë lejuar apo kryer shkelje të ligjit, që përbënin shkelje të disiplinës dhe në tërësi vlerësohet se gjatë veprimtarisë së tij ka lejuar apo kryer veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, Zyra e Inspektimit i propozon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, konstatimin e këtyre shkeljeve, duke i përcaktuar edhe llojin e masës që i korrespondon kësaj shkelje, për ta adresuar më pas në Komisionin Disiplinor, nëse Avokati i Përgjithshëm i Shtetit e vlerëson.

Neni 18

Kryerja e inspektimit të zyrës vendore

1. Për kryerjen e inspektimit të veprimtarisë të zyrës vendore, mbi bazën e Urdhërit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, drejtuesi i Zyrës së Inspektimit harton planin e inspektimit për zyrën konkrete.
2. Në përfundim të inspektimit, Zyra e Inspektimit, përgatit Raportin përkatës që duhet të përmbajë:
 - a. Të dhëna mbi organizimin e zyrës vendore/avokatëve të shtetit pranë ministrive dhe mjaftueshmërinë infrastrukture;
 - b. Të dhëna statistikore në drejtim të ngarkesës dhe shpejtësisë së kryerjes së shërbimeve në gjykatë.
 - c. Të dhëna statistikore në drejtim të cilësisë së veprimtarisë;
 - d. Rekomandime për përmirësimin e punës dhe/ose propozimin për procedim disiplinor për t'u trajtuar nga Komisioni Disiplinor.
3. Raporti i inspektimit i paraqitet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me konkluzionin përkatës.

Neni 19

Nismat që mund të rrjedhin nga rezultatet e inspektimit të zyrave vendore/avokatëve të shtetit pranë ministrive.

1. Në rastet kur nga raporti i inspektimit konstatohen të dhëna që vënë në dyshim pasjen e aftësive organizuese dhe menaxhuese të drejtuesit të zyrës vendore, Avokati i Përgjithshëm ngarkon strukturat e parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore, për vlerësimin e aftësive të drejtuesve të zyrave vendore.
2. Në rastet e identifikimit të dobësive, fenomeneve apo praktikave negative, Avokati i Përgjithshëm, urdhëron marrjen e masave për eliminimin e tyre në të ardhmen ose inicion nisma për përmirësimin e legjislacionit, të organizimit dhe infrastrukturës së zyrave vendore dhe avokatëve të shtetit pranë ministrive.

Neni 20

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve

Në çdo rast, kur në përfundim të verifikimit ose inspektimit janë dhënë rekomandime ose masa administrative apo masa disiplinore, brenda një afati të arsyeshëm, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, Zyra e Inspektimit verifikon zbatimin e tyre.

Neni 21

Regjistrat

1. Për evidentimin e veprimitarisë së tij, Zyra e Inspektimit mban dhe përditëson këto Regjistra:
 - a. Regjistri i ankesave;
 - b. Regjistri i inspektimeve të avokatëve të shtetit;
 - c. Regjistri i inspektimeve të zyrave vendore dhe avokatëve të shtetit pranë ministrive;
 - d. Regjistri i procedimeve disiplinore.
2. Regjistrat e mësipërm mbahen në mënyrë të shkruar dhe/ose elektronike nga avokati i zyrës së Inspektimit i ngarkuar për secilin regjistër, me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 22

Për aq sa nuk janë parashikuar në këtë Metodologji mbi elementët proceduralë dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit në të dyja nivelet nga Zyra e Inspektimit, do t'i referohemi si dispozitë plotësuese, Kodit të Procedurës Administrative.

Neni 23

Procesverbalet e verifikimit, inspektimit, urdhërat e inspektimit dhe verifikimit janë pjesë integrale e Metodologjisë së kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga Zyra e Inspektimit.

Neni 24

Hyrja në fuqi

Kjo metodologji hyn në fuqi me nënshkrimin e Urdhërit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, për miratimin e “Metodologjisë së elementëve proceduralë dhe materialë të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga Zyra e Inspektimit”.

Neni 25

Njoftimi

Pas miratimit të metodologjisë nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, akti publikohet në faqen zyrtare të internetit të Avokaturës së Shtetit, si dhe i njoftohet në adresat personale zyrtare të gjithë avokatëve të shtetit.

AVOKAT I PËRGJITHSHËMI SHTETIT

Artur Metani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. _____ prot

Tiranë, më ____ . ____ .2019

URDHËR

Nr. ____, datë ____ / ____ / ____

Për

“Ushtrim inspektimi tematik/të përgjithshëm lidhur me ____”

Unë Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 6, gërma (e) dhe neni 10 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 9/5 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhërin nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Kryerjen e inspektimit tematik/të përgjithshëm ndaj avokatit të shtetit _____
2. Objekt i inspektimit do të jetë:
3. Raporti Inspektimit të përfundojë me konkluzionet përkatëse, brenda datës _____.
4. Për kryerjen e inspektimit ngarkohen Avokatët e Shtetit, _____.
5. Ky urdhër t'i komunikohet z/zj. _____, si dhe Avokatëve të Shtetit, _____.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ARTUR METANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ prot

Tiranë, më _____.2019

URDHËR

Nr. ____, datë ____ / ____ / ____.

Për

“Për verifikimin lidhur me _____”.

Unë Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 6, gërma (e) dhe neni 10 i ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 9/5 të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhërin nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm,

URDHËROJ:

1. Kryerjen e verifikimit të _____ ndaj Avokatit të Shtetit _____
2. Objekt i verifikimit do të jetë:
3. Raporti verifikimit të përfundojë me konkluzionet përkatëse, brenda datës _____.
4. Për kryerjen e verifikimit ngarkohen Avokatët e Shtetit, _____.
5. Ky urdhër t'i komunikohet z/zj. _____, si dhe avokatëve të shtetit, _____.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ARTUR METANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

RAPORT – INSPEKTIMI

Drejtuar: Z. Artur Metani
Avokat i Përgjithshëm i Shtetit

Nga: Avokat Shteti, Zyra e Inspektimit

Lënda: Lidhur me Urdhrin Nr.____, datë ____ “Për ushtrim inspektimi tematik lidhur me përfaqësimin dhe mbrojtjen e një çështje”,

Datë:

I nderuar zoti Avokat i Përgjithshëm i Shtetit,

Me Urdhrin Nr.____, datë ____ “Për ushtrim inspektimi tematik/të përgjithshëm lidhur ____” janë caktuar për ushtrimin e inspektimit, sipas tematikës së përcaktuar në këtë urdhër, Avokatët e Shtetit pranë Zyrës së Inspektimit z/znj._____.

Për nisjen e këtij inspektimi ndaj Avokatit të Shtetit_____, kanë shërbyer si shkak

Raporti i inspektimit i referohet

1. Objekt i inspektimit, sipas pikës 1 të urdhërit të mësipërm, ishte:

Në bazë të akteve të administruara në dosje, ka rezultuar se _____

Në lidhje sa më sipër, theksoj se objekt i inspektimit, sipas urdhrit nr. ____, datë _____ kanë qene veprimet e Avokatit të Shtetit, në lidhje me _____.

KONKLuzion:

PËRFUNDIM:

Në përfundim të raportit të inspektimit, në bazë të neneve 29, 30 dhe 31 të Ligjit Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, vlerësoj që ndaj z./znj _____ të merret masa disiplinore e parashikuar nga neni 31/3/b i Ligjit Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, “_____”.

Ky Raport Inspektimi mbahet në _____ kopje, i përbërë nga _____ faqe dhe i nënshkruar në çdo fletë, ku një kopje i komunikohet Avokatit të Shtetit Z/Znj _____, një kopje për Zyrën e Inspektimit dhe një kopje për protokollin.

Zyra e Inspektimit

Avokate Shteti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

PROCESVERBAL

NR. _____, DATË _____, 201 _____

PËR

VERFIKIMIN E _____

Bazuar në nenin 10 të ligjit Nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, nenit 19 të Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit", miratuar me Urdhërin nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm, nenit 15 të Metodologjisë së Inspektimit, si dhe urdhërit nr. _____, datë _____ mbahet procesverbal verifikimi, sot më datë _____.

Avokatët e Shtetit të Zyrës së Inspektimit
Z/Znj. _____
verifikuan ankesën e bërë ndaj avokatit të shtetit z/znj _____

KONSTATUAN:

1. Shkelje të _____

2. Parashikimi ligjor _____

3. Vlerësimi i situatës _____

PËR KËTO ARSYE

Duke vlerësuar sa më sipër si shkelje disiplinore, avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit vendosën për njoftimin e Avokatit të Përgjithshëm, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedimit disiplinor.

Avokatët e Shtetit

1. _____
2. _____
3. _____

Avokati i shtetit subjekt inspektimi

1. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Procesverbal

I mbajtur sot më datë ____2019 në prezencë të Avokatëve të Shtetit pranë Zyrës së Inspektimit z/znj _____, në zbatim të Urdhërit nr. ____, datë _____2019,

Pyetje:

Përgjigje:

Procesverbali pasi lexohet firmoset pa vërejtje.

Avokatët e Shtetit